




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 691/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa nr.552/17, datë 18.07.2017 e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Ekonomik në Prishtinë për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr.568/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit te akreditimit sipas vendimit nr.568/17, datë 06.07.2017 për programet e studimit:
 - Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS;
 - Ekonomiks (ne gjuhën Angleze), PhD, 180, ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve ne programin e cekura ne piken dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.568/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Ekonomik me 14.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr. 562/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Ekonomik i është pezulluar akreditimi për katër programe të studimit: Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS; Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, MA, 120 ECTS; Ekonomiks, PhD, 180, ECTS, dhe Ekonomiks (ne gjuhën Angleze), PhD, 180, ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit te dorëzuar (me datë 18.07.2017 dhe 26.07.2017) nga Fakultetit Ekonomik i Universitetit të Prishtinës, KSHC ka konstatuar që programet e studimit Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, dhe Ekonomiks (ne gjuhën Angleze), PhD, 180 ECTS i plotëson kushtet sa i

1/2

përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

